



www.vasiltole.com

NGA I NJËJTI AUTOR:

- Muzika dhe letërsia, '97
- Sazet, muzika me saze + CD, '98
- Iso polifonia shqiptare I, '99
- Strukturë dhe analizë II, 2000
- Enciklopedia e muzikës popullore IV, '01
- Monodia shqiptare III, '02
- Himni Kombëtar, + CD, '03
- Trashëgimia shpirtërore në CD, '04
- Cluster, '04
- Odiseja dhe Sirenat..., '05
- Enciklopedia e iso polifonisë, + CD, '07
- Usta Laver Bariu, + CD, '08

“E qara me bote” si një këngëtim vajtimor shumëzërësh, përfshin një masë të madhe njerëzish në vajtim, të cilët, përmes këtij rituali shumelementesh, nderojnë të vdekurin e po aq “zbusin” dhe peshën reale të vdekjes të përjetuar prej tyre në formë dhimbjeje...

... Në ndryshim nga kultura dionisiane, kultura korale muzikore iso-polifonike na dëshmon se jeta nuk mund të jetë një gëzim pa mbarim, por ajo është shprehje e kalimit nga dhimbja e zezë drejt gëzimit të bardhë dhe anasjelltas...



Çmimi 500 lekë


“PSE QANË KUAJT E AKILIT?” VASIL S. TOLE

SHTËPIA BOTUESE
mediaprint

VASIL S. TOLE

“PSE QANË KUAJT E AKILIT?”

“E qara me bote” dhe prejardhja e iso-polifonisë popullore shqiptare



SHTËPIA BOTUESE
mediaprint



“Iliada”

“Jashta përleshjes qanin kuajt e Akilit, sapo e panë që humbën qerregasin, të shtrirë në pluhur nga Hektor gjaksori...”

Por si qëndron drejt pa lëvizur shtylla në krye të varrit të një burri a gruaje, ashtu të shtangur rrinin duke mbajtur qerrin e bukur; kokat poshtë të ulura e prej qepallash lot të nxehtë u rridhnin rrëke përdhe, aq dhembje u ra për prijsin Jelet e gjata derdhur jashtë kularëve iu zhyen përtokë”

“Pse qanë kuajt e Akilit?”

“E qara me bote” dhe prejardhja e
iso-polifonisë popullore shqiptare

VASIL S. TOLE

“Pse qanë kuajt e Akilit?”

“E qara me bote” dhe prejardhja e
iso-polifonisë popullore shqiptare

Sprovë etnomuzikologjike

SHTËPIA BOTUESE
mediaprint

Tiranë, 2011

Vasil S. Tole

“Pse qanë kuajt e Akilit”?

“E qara me bote” dhe prejardhja e iso-polifonisë popullore shqiptare,

pjesë e “Listës përfaqësuese të trashëgimisë gojore dhe shpirtërore të njerëzimit”, mbrojtur nga UNESCO dhe “Kryevepër e trashëgimisë kulturore shpirtërore kombëtare”

Sprovë etnomuzikologjike

• Mirënjohja për botimin e librit i shkon shokut tim z. Behar Male

Ballina: **Georgi S. Tole**

Redaktor shkencor: **Prof. Dr. Fatmir Hysi**

Redaktor letrar: **Stefan Koçi**

Radhitja: **Enkeleida Papa**

Design & Layout: **Elzana Agolli**

Foto e kopertinës: **Alket Islami**

• *“Tuma e Kamenicës”,* Korçë, shek. XV-të p.e.s. Botimi i fotografisë mundësohet nga Dr. Lorenc Bejko, drejtues i projektit arkeologjik të studimit të kësaj tume.

Foto e mbrapshtinës: **Valle labe me dy rreshta**

• Grupi iso-polifonik i Tepelenës në FFK - Gjirokastrë, 1968. Udhëheq vallen Alush Milori, Progonat, Kurvelesh. Botimi i fotografisë mundësohet nga Prof. Dr. Ramazan H. Bogdani.

ISBN: 978-99956-93-40-4

© **Të gjitha të drejtat të autorit**

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij punimi nuk mund të riprodhohet, të ritregohet në ndonjë mënyrë ose sistem tjetër, apo të transmetohet në ndonjë formë që kupton fotokopjimin, regjistrimin, transmetimet radio- përhapëse etj., pa lejen me shkrim të autorit.

SHËTËPIA BOTËSE
mediaprint

www.mediaprint.al
Kutia Postare 7467 - Tiranë; Tel.: 04 2258 156;
Cel.: 069 40 44 443; botime@mediaprint.al

“Iliada”

*“Jashta përleshjes qanin kuajt e Akilit,
sapo e panë që humbën qerregasin,
të shtrirë në pluhur nga Hektor gjaksori...*

.....
*Por si qëndron drejt pa lëvizur shtylla
në krye të varrit të një burri a gruaje,
ashtu të shtangur rrinin duke mbajtur
qerrin e bukur; kokat poshtë të ulura
e prej qepallash lot të nxehtë u rridhnin
rrëke përdhe, aq dhembje u ra për prijsin
Jelet e gjata derdhur jashtë kularëve
iu zhyen përtokë”¹*

1 Homeri, “Iliada”, Tiranë, 2006, Kënga XVII fq. 400.
Përkthyes Pashko Gjeçi.

Përkushtim

Këtë botim ua kushtoj gjyshërve dhe gjysheve të mia: **Vasil Ziso Tole** (Lupckë, Përmet 1886 - † Përmet 1952), **Afroviti Kalam Grigoriadhis** (Stamboll, Turqi 1907 - † Lupckë, Përmet 1987) dhe **Irakli (Rako) Mihal Koçi** (Ndëran, Zagori 1910 - † Zagori 1958), **Sorka Petro Dilo** (Topovë, Zagori 1910 - † Gjirokastër 1992).

Me përlësinë, mirënjohjen dhe nderimin më të thellë për ta!

Autori

Përmbajtja e lëndës

Parathënie		11
HYRJE	<i>“Mbi vajin dhe vajtimin tragjik”</i>	15
Kap. I	<i>“E qara me bote-ulërimë”, shtrati i lindjes së isopolifonisë</i>	35
1.1	<i>Etimologjia e fjalës</i>	36
1.2	<i>“Bota e përtejme dhe “e qara me bote” si terapi muzikore dhe ndërlidhëse botësh”</i>	38
1.3	<i>Dëshmitë e hershme në lidhje me “të qarën me bote”</i>	50
1.4	<i>Veçoritë e këndimit vajtimor</i>	72
1.5	<i>Simbolika e ngjyrave “kuq e zi” të identitetit kombëtar shqiptar</i>	82
Kap. II	<i>“Iso-polifonia, kultura shpirtërore kundër dhimbjes”</i>	91
2.1	<i>Hapja dhe mbyllja e vajit</i>	91
2.2	<i>Koha e zisë dhe mbyllja e zisë</i>	106
2.3	<i>Vajtimi dhe gjuha shqipe e kënduar: fjalët e urta</i>	112

2.4	<i>Gjinitë dhe format e tjera muzikore iso-polifonike vajtuese</i>	121
Kap. III	“Iso-polifonia si kor muzikor”	131
3.1	<i>Kori muzikor i iso-polifonisë dhe kori i tragjedisë</i>	131
3.2	<i>Struktura e zërave të iso-polifonisë</i>	146
3.3	<i>Këndimi pa dirigjent dhe pozicionet e vajtuesve</i>	155
Kap. IV	“Pse qanë kuajt e Akilit?": Ritualet tragjike tek “Iliada” dhe “Odiseja” e Homerit dhe tiparet e përbashkëta të vajtimeve”.	165
4.1	<i>Rituali i Patroklit</i>	166
4.2	<i>Rituali i Hektorit</i>	174
4.3	<i>Rituali i Akilit</i>	179
Epilog	“ <i>Kuajt e Akilit</i> ”, poezi nga Kostandin Kavafis	189
Materialet muzikore të konsultuara në Arkivin e IAKSA-s		191
Treguesi i emrave		195
Për autorin		197

Parathënie

Ky botim është studimi i radhës, pas *“Odisesë dhe Sirenave: grishje drejt viseve iso-polifonike të Epirit”*, që ndër të tjera i referohet edhe veprës së Homerit, në këndvështrimin etnomuzikologjik. *“Pse qanë kuajt e Akilit”*, është vetëm një simbol për t`u futur në domethënien e praktikave ritualistike arkaike vajtimore, si një mundësi më shumë për t`iu afruar rrënjëve të antropogjenezës shqiptare, thelbit dhe prejardhjes së muzikës dhe këndimit iso-polifonik vajtues, si kulturë për jetën, kundër dhimbjes.

E shkuara e studimeve tona etnomuzikologjike në fushën e iso-polifonisë muzikore popullore, për hir të së vërtetës, ka synuar më shumë analizën e gjerësisë së dukurisë së iso-polifonisë, se sa thellësinë drejt prejardhjes, shtresëzimeve dhe rrënjëve të saj të stërlashta. Në fakt, me kohë ka qënë vënë re se në traditat

popullore shqiptare janë të mbivendosura shtresëzime kulturash: ... *kruej një shtresë del tjetra me dishmina të çuditshme ngjarjesh. Tue hjekë një shtresë e tue gjetë tjetrën arrin dijetari në parahistori*². Pra, ashtu si në rastin e traditave popullore shqiptare, na duket se edhe gjatë hulumtimit të origjinës së isopolifonisë në Shqipërinë e Jugut, vërejmë teknikën e palimpsestit.

Në lidhje me sa më sipër, mendojmë se është e mundur të bëhet një rikthim në prejardhjen e saj, nisur pikërisht nga disa copëza elementesh apo dukurish të vajkëndimit dhe strukturimit iso-polifonik që vazhdojnë të ekzistojnë. Kështu, duke kruar një shtresë dhe duke dalë dëshmi të reja, mund t'i afrohemi burimit të lëndës sonë të vjetër, në mënyrë të veçantë të *“korit vajtimor”*, *“të qarës me boteme ulërimë”* dhe asaj *“me ligje”*, si fillesa e isopolifonisë popullore shqiptare dhe e krijimeve artistike shpirtërore popullore në përgjithësi, një nga dukuritë më të hershme të muzikës shumëzërëshe në Europë, e më gjerë.

2 Koliqi, Ernest: *“Vepra 6”*, Prishtinë, 2003, fq. 587.

“Pse qanë kuajt e Akilit?”

Dëshirojmë që ky studim të mos jetë një gur mbi boshllëk, por një tjetër gur mbi gur, i vendosur në murin e përpjekjeve që ngrihet përditë nga njerëzit e kulturës. Le ta gjykojë lexuesi, se sa i rëndë dhe në vend të vetë është ky gur.

Autori